



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.217/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbarimore të kreditorit N.P.N Loni, rruga e Reshtanit Komuna e Suharekës, nr. Biznesi 80097573 te cilin e përfaqëson avokat Pajtim Lezi nga Suhareka, ndaj debitorit Restorant ILIRIA me pronar Xh.G. nga fshati Studençan Komuna e Suharekës, te cilin e përfaqëson avokat Muhamet Shala nga Prizreni, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar përmes përfaqësuesit te autorizuar, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega ne Suharekë, PP nr.162/22 datë 30.05.2022, me datën 29.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e debitorit Restorant ILIRIA me pronar Xh.G. nga fshati Studençan Komuna e Suharekës, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega ne Suharekë, PP.nr.162/22 i datës 30.05.2022, dhe Lënda i kthehet Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Dega ne Suharekë, me aktvendimin e atakuar PP.nr.162/22 dt.30.05.2022, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit Restorant ILIRIA me pronar Xh.G. nga fshati Studençan Komuna e Suharekës, dhe ka Detyruar Përmbaruesen Private Saranda Kuqi nga Suhareka qe ta mbaj seancën e ankandit publik te cilën e ka caktuar paraprakisht sipas konkluzionit P.nr.992/17 dt.15.02.2022 në ora 10:00.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori përmes përfaqësuesit te autorizuar, për shkak te konstatimit të gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë këtë ankesë ta aprovoj si te bazuar dhe debitorit Xh.G. t,ia kthej librezat dhe traktorin me shënime si në shkresa të lëndës.

Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.P.N “Loni”, rruga e Reshtanit Komuna e Suharekës, nr. Biznesi 80097573, me datën 11.09.2017 ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit ”Restorant “ILIRIA” me pronar Xh.G. nga fshati Studençan Komuna e Suharekës, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr.0106/16 dt.01.06.2016. Përmbarruesja Private Saranda Kuqi nga Suhareka, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.992/2017 dt.11.09.2017, ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit nga fatura, t’ia paguajë shumën prej 4,148.20 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e arritjes së kërkesës për pagesë si dhe shpenzimet e përmbarrimit.

Kundër urdhrin përmbarrimor debitori ka ushtruar prapësim me datën 10.11.2017, me pretendimin se urdhri përmbarrimor është drejtuar ndaj debitorit i cili në fakt si person juridik nuk është i regjistruar në emër të Xh.G.j dhe si provë kemi certifikatën e biznesit ku ky restorant është në emër të Sh.G. pra palës i mungon legjitimiteti pasiv i palës debitorë. Kuponat në të cilat kinse Hotel Iliria ngarkohet me borxhin janë të lëshuara jo në emër të Restorantit por në emër të personit fizik Xh.G. dhe janë të nënshkruar në emër të njëjtit, propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, propozimin për përmbarrim ta refuzoj si të pabazuar dhe ta detyroj kreditorin të paguaj shpenzimet e procedurës duke detyruar përmbarruesin privat të zhbllokoj menjëherë llogaritë e Restorant Ilirija.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori me datën 13.11.2017, me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore për përmbarrim në rastin konkret dhe se pronar i restorant Ilirija deri në vitin 2014 ka qenë Xh.G. ndërsa pas vitit 2014 është shëndërruar në NHSH Iliria De Luxe me pronar Sh.G. me të njëjtin numër të biznesit dhe se fjala është për borxhin deri në periudhën e vitit 2014 sipas paragonave. Debitori nuk ka ofruar asnjë provë në bazë të cilës e mbështetë kundërshtimin e tij ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP. Propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta obligoj debitorin të paguaj shpenzimet e procedurës.

Pas vendimeve të gjykatave kompetente, lidhur me prapësimin e debitorit, përmbarruesi privat ka nxjerr Konkluzionin P.nr.992/17 dt.22.01.2022. Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, duke vepruar sipas ankesës së debitorit për evitimin e parregullsive në procedurë përmbarrimore, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, PP.nr.162/22 dt.30.05.2022, me të cilin e ka aprovuar ankesën e debitorit dhe ka detyruar përmbarruesen private të mbaj seancën e ankandit publik me të cilën e ka caktuar paraprakisht sipas Konkluzionit P.nr.992/17 dt.15.02.2022 në ora 10:00. Në arsyetim të aktvendimit Gjykata e shkalles së parë ka theksuar se nga rrjedha e procedurës së ekzekutimit nga ana e përmbarrueses private dhe nga shkresat e lëndës gjykata gjen se përmbarruesja private Saranda Kuqi deri në caktimin e seancës së ankandit publik me dt.15.02.2022 ka vepruar, komunikuar me palën debitore me parashtrës konform dispozitave ligjore të LPP, por nga shkresat e lëndës nuk

ka prova se çka ka ndodhur me çështjen e seancës së ankandit publik dt.15.02.2022 pasi mungon procesverbali i kësaj seance.

Gjykata Komerciale -Dhoma e shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Në këtë kontekst, kjo gjykatë vlerëson se në bazë të shkresave të lëndës, dhe arsytimit të aktvendimit ankimor, rezulton se gjendja e vërtetuar nga ana e gjykatës e shkallës së parë del të mos jetë vërtetuar drejtë dhe saktë, sepse debitori në ankesën e tij për eliminim të parregullsisve drejtuar gjykatës përmes përmbauesit privat, ka kërkuar të evitohen parregullsitë e kësaj çështje përmbaimore dhe ti kthehen librezat dhe traktori që kanë qenë objekte në këtë çështje përmbaimore. Ndërsa gjykata e shkallës së parë në këtë rast aprovon ankesën e debitorit, duke e detyruar përmbauesin privat që të mbaj seancën e ankandit publik, të cilën e ka caktuar paraprakisht sipas konkluzionit P.nr.992/17 për datën 15.02.2022, në ora 10.00.

Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se ky arsyetim i aktvendimit të atakuar është i përfshire me shkelje të nenit 182 par.2 pika (n) të LPK-së, sepse është juridikisht i pa qartë kundërthënës me vet vetën dhe arsyetimin e tij, dhe nuk janë treguar faktet vendimtare. Kjo gjykatë vlerësoi se gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të atakuar, nuk ka shqyrtuar ankesën e debitorit sa i përket evitimit të parregullsisve në drejtim të kthimit të librezave dhe traktorit, por ka obliguar përmbauesin privat që të mbaj seancën e ankandit publik, i cili veprim rezulton të mos jetë kërkesë e debitorit në ankesë.

Andaj me qëllim të analizimit të tërë rrjedhës së procedurës, veprimeve të ndërmarra nga ana e përmbauesit privat, pretendimet e debitorit, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në shkallë të parë në rishqyrtim.

Në ri procedurë, Dhoma e shkallës së parë e Gjykatës Komerciale, duhet të ketë parasysht të gjeturat e gjykatës së shkallës së dytë, të vlerësoj pretendimet ankimore të debitorit, të konstatoj drejt gjendjen faktike nga shkresat e lëndës, dhe të vendos konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.217/23 me datë 29.03.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha